




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-24805/22 datë: 24.08.2022



Npi – 01/266 datë: 30.08.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.08.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.08.2022 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje përveç Kryesuesit z.Bajram Ilazi dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, znj.Shkurte Behluli dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: z.Xhavit Fejza përfaqësues nga UNMIK, z.Muharrem Haziri nga OSBE, dhe z.Shqiprim Hyseni, - Praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së me 04.07.2022,
2. Propozim për Kuvendin Komunal të Komunës së Shtimes, Zyrën e Kryetarit, Drejtorive përkatëse dhe organizatat joqeveritare për mbështetje në hartimin e planit të veprimit lokal për komunitete,
3. Propozim për organizimin e takimeve me institucionet qendrore për çështjen : Lloji i ndihmës së mundëshme për komunitetet Ashkali dhe Rom të Komunës së Shtimes,
4. Prezantimi dhe raportimi nga Drejtori i qendrës për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali dhe Rom,
5. Propozim për krijimin e analizës së çështjes së strehimit dhe banimit të komuniteteve,
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

z.Burim Fazliu, nga Q.P.S; I propozoj Komitetit që pika 4 të dal në pikën 2 për mos me pritë unë shumë gjatë për prezantimin e kësaj pike që duhet ta bëj.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, po më vjen mirë që jemi mbledhur të gjithë si Komitet, i cili na ka munguar në këto dy seancat e kaluara, besoj që nuk do të ndodh në të ardhmen një gjë e tillë. Sa i përket pikave të rendit të ditës e kam një sygjërim për Kryesuesin që pikat e rendit të ditës paraprakisht duhet me u diskutuar me Zyrën për Komunitete, mbase po flasim për një propozim

që do ti bëhet Kuvendit rreth hartimit të Planit Lokal të Veprimit, ne e dimë që është një plan mjaftë i tillë i cili është mjaft voluminoz, e i cili donë një përkushtim jashtëzakonisht të madh, sidomos të këtyre personave që merren me këtë çështje. Ti propozojmë Kuvendit miratimin e një plani i cili duhet të ishte me patjetër, megjithatë Zyra për Komunitete ka qenë dashur të jetë prezentë këtu, dhe sadopak të na jep një lloj informimi rreth pikave të rendit të ditës, qoftë për planin lokal të veprimit për komunitete që mendoj se është e rëndësishme, qoftë edhe për pikat tjera, prandaj mendoj se duhet paraprakisht me ditë prej anës së juaj se sa është bashkëpunimi në mes Zyrës për Komunitete, në krye të së cilës është z.Ibrahim Demiri, me këtë Komitet për Komunitete, ku ne krye jeni ju. Ndërsa sa i përket propozimit të përfaqësuesit të QPS-së për ndryshimin e radhitje së pikave nga pika e 4 në të 2.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Do e hedhim në votim këtë ndryshim të renditjes së pikave. Në mbledhjen e kaluar kemi hartuar një plan të punës të këtij Komiteti, ku bashkërisht me Shkurten, Muhametin dhe në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete kemi punuar në planin e punës. Ideja ka qenë që të jenë gjithë akterët e përfshirë në këtë plan, i njëjti plan i punës është votuar nga anëtarët e Komitetit për Komunitete, dhe gjitha pikat janë në koordinim me planin e punës. Pa dyshim se bashkëpunimi ekziston mes Zyrës për Komunitete në Komunën e Shtimes. Sa i përket planit të veprimit lokal për Komunitete, momentin që është hartuar në nivel Nacional, menjëherë kemi hedhur hapa të menjëhershëm për hartimin të këtij plani, në Ferizaj, shembull Planin është hartu nga organizata "VORAE", kurse në Komunat tjera është hartuar nga organizata tjera. Ky plan pastaj duhet të hidhet në votim nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, propozimi ka qenë që Zyra e Kryetarit dhe organizatat tjera, që të ndihmojnë në hartimin e planit të veprimit për komunitete.

z.Besnik Seferi; Te ky plan nuk po mundem me kuptuar diçka, sepse sipas dinamikës plani kalon në dy faza, dua të pyes ky plan a do ti shkoj drejtorive, pasi s'po kemi dokument konkret para vetes, prandaj e mira të mirës është që secilën herë kur votohet diçka të kemi para vetës një plan një dokument në formë të shkruar, si dëshmi se çka po votojmë, unë po e kuptoj si plan por anëtarët e tjerë duhet ta kenë përpara, dhe duhet të jenë përfaqësuesit kryesor siç është zyrtari për komunitete dhe kthim, këtu e kam përshtypjen time që mos të ngutemi

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Në fakt te pika e dytë kam pasur me dhënë më shumë sqarime, ne duhet me bashkëpunuar me Zyrën për Komunitet, por duhet me pas parasysh që edhe ne secili këtu nuk kemi ardhur rastësisht këtu në këtë Komitet, një far mënyre jemi përfaqësues të Komuniteteve por nuk është që jemi pjesë e institucioneve në mënyre direkte. Hedhim në votim propozimin e burimit që pika e 4 të kaloj në pikën 2.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi propozimin e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale, z.Burim Fazliu, që pika e 4 të zhvendoset në pikën e 2, dhe anasjelltas.**

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi, rendin e ditës me propozimin e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale, z.Burim Fazliut.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së më 04.07.2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Po e shohim që është edhe një procesmbajtës, mendoj që do të ja lehtësoj punën Idajetit, prandaj i urojë suksese në punë, mendoj që duhet të ketë jo vetëm Komiteti por edhe Kuvendi një procesmbajtës të dytë për me i ndihmuar edhe Idajetit e që ne mos të kemi diskutime e që diçka mundet me i ikë për shkak të fjalimeve tona, prandaj sukses juve dhe skam ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Kërkoj falje që nuk munda me i përshëndet në fillim përfaqësuesit e OSBE dhe tjerët kërkoj ndjese. Atëherë po vazhdojmë nëse dikush ka me diskutuar lidhur me pikën sa i përket ekstrakt procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 04.07.2022.**

Pika 2

Prezantimi dhe raportimi nga Drejtori i qendrës për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali dhe Rom,

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike Kryesuesi fjalën ja dha përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Përshëndetje, ju faleminderit për ftesën, ju e keni kërkuar një informatë nga QPS-e mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali dhe Rom. Shkojmë me shifra konkrete, gjithësej nga dy komunitetet janë 61 raste sociale, 60 janë të komunitetit ashkali dhe një familje është nga komuniteti rom.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Kto 61 raste nëse mundeni me dit cilës kategori i përkasin a janë këta që ju takon asistenca vetëm për fëmijë apo edhe kategori tjera.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Janë dy kategori, kategoria parë janë personat që kanë probleme shëndetësore dhe kategoria e dytë janë personat apo familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe që e kanë një fëmijë nën moshën 5 vjeçare, shumica janë të përfshirë në këtë kategori dhe dytë por ka edhe një pjesë që janë me probleme shëndetësore, po ashtu kanë edhe gjendjen e vështirë ekonomike, roli jon si QPS-ë është që të ofrojmë shërbime për gjitha komunitetet në Komunën e Shtimes, e në këtë rast edhe për komunitetin ashkali dhe rom. QPS asnjëherë nuk bën diferencime. Ne të gjitha komunitetet i shohim njëjtë, duke marrë përsysh gjitha kapacitetet tona ju kemi dal në ndihmë të gjithë qytetarëve pa dallim. Ndihmat kanë qenë, duke përfshirë pako ushqimore, pako higjienike, veshmbathje, mjete didaktike për fëmijë të klasës 1 deri në 5 të gjitha mundësit që ofron QPS-ë nuk është anashkaluar në asnjë rast ndonjë i komuniteti tjetër jo shumicë, po ashtu kemi dhanë për shumë familje raporte analiza sociale të cilat kanë nevoja për banim, pasi që ne si QPS-ë nuk kemi buxhet, gjitha kërkesat ja drejtojmë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Shtimes. Deri tani kemi shpërndarë afro 1800 pako ushqimore, gjitha këto familje minimumi është që i kanë marr nga 5 pako, duke marr parasysh edhe rrethanat në të cilat jetojnë, si numri e anëtareve të familjes, gjendjen shëndetësore, për arsye që një pjesë e tyre nuk janë të kyçur në tregun e punës. Po ashtu i kemi përkrahë edhe përmes donatorëve edhe me bona ushqimor, është edhe një pjesë që organizata IOM-i na ka ofruar dru, pastaj UNDP-ja po ashtu, edhe me shoqatat e ndryshme kemi pasur bashkëpunim, megjithatë me kushtet dhe mundësit tona jemi mundu që t'i rrimë ngatë këtyre kategorive të familjeve.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, e falënderoi OSBE-në si dhe organizatat tjera, sepse e kanë ndihmuar shumë komunitetin tonë, por është një numër i madh i kërkesave të komuniteti rom dhe ashkali, prandaj kisha kërkuar që nëse ekziston mundësia për 20 familje të përkrahen me pako, të cilat janë shumë keq, duke parë që tani është shumë më vështirë, sepse çmimet janë ngritur.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, dëshiroj me cek se kohën kur kam bërë praktikën, ka qenë një bashkëpunim i mirë me organizatat, për me marrë bona për ushqim, dëshiroj me dit a po vazhdon ky bashkëpunim ende, apo jo nuk e mbaj mend cilat organizata kanë qenë donator.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Ka qenë IOM-i dhe UNDP-ja që na kanë përkrah, ka qenë një projekt 6 mujorë, mirëpo janë duke u furnizuar ende. Komuniteti ashkali dhe rom, qendrën e kanë në Lipjan me një depo.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Njëra ndër pikat në këtë mbledhje është edhe çështja e strehimit, ju e përmendët, që ka raste që kanë nevoja për banim, ne jemi informuar edhe në teren, ju e dini edhe më mirë se sa familje, pra sa është numri i tyre që kanë nevoja për strehim.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Nuk ka qenë kjo pikë për me raportuar, prandaj edhe skam shënime, por nuk është numër i madh, disa janë për shkak të rritjes së numrit të anëtareve të familjes, një pjesë është që kanë qenë me qira dhe qiradhënësi është kthyer nga bota jashtme dhe

është dashur me liru objektin e banimit. Ne si qendër nuk kemi buxhet për strehim, e kemi një plan për banim social por i cili nuk është i buxhetuar.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Besoj mundemi me ardhur me marrë të dhëna shtesë në zyrën tuaj, arsyerja që po e ceki këtë është se në Komunën tonë qarkullojnë disa statistika sa i përket familjeve që kanë nevoja për strehim, kemi pasur raste kur familjet me nevoja urgjente nuk u është rinovuar shtëpia, ndërsa familjeve me raste më pak urgjente ju është rinovua apo ndërtuar shtëpia nga fillimi, apo janë mbështetur dy herë, ne mundemi me ju drejtuar me një shkresë zyrtare sepse të dhënat e juaja janë më urgjente.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Të gjitha kërkesat drejtohen në Komunë, dhe pastaj arrijnë në QPS-e, zyrtarët e QPS-së posa ti marrin kërkesat, dalin në teren e shikojnë, gjendjen bëjnë raportin lidhur me rastin. Te kjo pjesa e mbështetjes, në nuk kemi buxhet, e ndonjëherë ka raste kur familja është shumë në gjendje të vështirë por nuk ka tokë për ndërtimin e një shtëpie, atëherë ti nuk ke mundësi me i dhënë tok, prandaj duhet me kalu pa vullnetin tonë e me marrë dikën tjetër si rast për me trajtuar, i cili është në kushte të përafërta por që ka tokë në dispozicion, kështu që ka shumë specifika që duhet ta bëjmë përzgjedhjen.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; E falënderojmë drejtorin e QPS-së për informatën, nëse dikush dëshiron me diskutuar edhe diçka.

z.Besnik Seferi; E falënderojmë drejtorin, sa i përket informatës ndoshta është një e metë e madhe që nuk na ka ardhur në formë të shkruar si dokument ky raport, shumë e pyetja u bë nga parafolësit por mua me intereson cila ka qen ndihma për veq asistencës sociale që është bërë, pra a ka pasur ndonjë ndihmë tjetër për këto familje të këtij komuniteti, dhe sa i përket vizitave ne para pak muajsh e kemi pasur një vizitë të Komitetit për Komunitete të një familje gjë e cila na ka shqetësuar shumë gjendja e këtyre familjeve të cilat nuk kanë as kulm mbi kokë. Ata me një formë nuk u shprehen të pakënaqur karshi ndihmës të QPS-së, me pako ushqimore, por u shprehen të pakënaqur lidhur me mos realizimin kërkesave të tyre lidhur me çështjen e banimit që të kanë një kulm mbi kokë, e të kalojnë sa ma mirë këtë dimër që po ofrohet. Mua më shqetësoi jashtëzakonisht. Çka ka bërë QPS-ja me këto familje, ju e thatë shumë mirë se Komuna nuk ka buxhet për këto kërkesa, cilat kanë qenë hapat që i keni ndërmarr deri tash ju si Qendër lidhur me këto kërkesa, që dihet nëse nuk kemi buxhet të paktën duhet me hulumtuar me gjet ndonjë mundësi apo alternativ tjetër, a është bashkëpunimi mes Shoqatës së Jetimave të Ballkanit, ku e dimë që një bashkëpunim i tillë ka qen para dy ose tri viteve? A është duke vazhduar dhe a planifikohet një bashkëpunim i tillë që të behët realizimi i ndërtimit të shtëpive të tyre? Kam një rast konkret është fjala për Sherif Jashari, ai është një familje e cila jeton në kushte jashtëzakonisht të renda, e QPS-së, nuk ka marr ndonjë hap lidhur me këtë familje, por duhet ta di se a ka bërë ndonjë kërkesë në këtë Qendër, dhe a është trajtuar kërkesa e tij, ata jetojnë me qira ku nuk i plotëson kushtet elementare për jetë. Ne kemi pasur rast si Komitet për me i vizituar ku për veç kësaj familje, ka edhe problematika tjera ku janë duke hequr edhe për gjana bazike, si çështja e rrymës ku e kemi përmendur edhe në Kuvendin, kjo familje është në depresion pavarësisht asaj që ja kanë ndërtuar shtëpinë, ajo nuk ka furnizim me energji elektrike mbi 7 muaj. Dua ta di se QPS-ja, a është duke bërë vizita. Na ka prek si rast e nuk ndihna rahat.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Ky është duke banuar me qira te Furra "Berlini".

z.Besnik Seferi; Jo sa e di unë është te furra "Drini Bardh".

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Siç ju thash edhe më herët QPS-së nuk ka buxhet për këtë punë të banimit dhe strehimit këto raste i drejtojmë në Drejtorinë e Shëndetësisë. Bashkëpunimin me shoqatat e kemi nga 2018 e 2019 bashkëpunim me Shoqatën "Jetimet e Ballkanit" ku janë ndërtuar katër shtëpi, e kemi një donator për një familje shqiptare, kemi pasur një karkës në nivel të drejtorisë, kemi bërë listën e ngushtë, listën e ka marrë donatori, e rëndësishme është që e kemi bërë kërkesën te donatori. Sa i përket Sherif Hasanit ne nuk kemi buxhet me i bërë zgjidhje, këtë duhet ta bënë Drejtoria e Shëndetësisë, te çështja e rrymës, skema sociale është e dizajnuar ashtu që një pjesë me ja paguar, e pjesën tjetër nuk mundemi me bë zgjidhje, ajo llogaritet një mall që e

ka ble, i kemi rastet me emër, ne e kemi orientuar te zyra për komunitete, e kjo zyre pastaj ka drejt me ju drejtuar KEDS-it.

z.Besnik Seferi; A është kompetencë e QPS-së me i dhanë edhe ndihma juridike rasteve lidhur me përgatitjen e dosjeve.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Jo nuk është kompetencë e QPS-së, tani në Komunën tonë kemi një zyre për dhënien e ndihmës juridike falas, të cilës mund ti drejtohen të gjithë, kjo është hapë që një vit, me gjithë atë çdo palë që drejtohet te na e orientojmë se ku duhet të kërkoj ndihmë ma tutje. E jona është lajmërimi edhe orientimi.

z.Arton Demiri; Vetëm edhe këto pako ushqimore, nëse mundeni me i pru për këto familje do të ishte mirë, edhe ashtu njëherë për një herë është në rregull.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Te pakot ushqimore ne jemi duke vazhduar, por ti mundesh me na sjellë një listë me emra që mendon se kanë nevoja dhe ne bëjmë shqyrtimin e listës dhe dalim në teren, mandej i futim në këtë listën tonë që është duke vazhduar. Sipas rasteve që i kemi ne do të ndajmë pakot, e jo dikush të merr 5 e dikush asnjë, mirëpo ne nuk kemi buxhet, përveç donatorëve, të cilët i falënderojmë, siq janë "Eli Abi" i cili na përkrah me 100 deri 150 kuponë me vlerë deri në 50 euro.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Dua me të falënderu për informatën, Komuna jonë sipas asaj që na prezantove qëndron shumë mirë në krahasim me Komunitat tjera, që po i bjen dikun rreth 35% të përfituesve janë të komuniteteve pakicë. Sa i përket kategorive ne kemi taku familje që janë me probleme shëndetësore, qysh është mundësia për me i ndihmuar.

z.Burim Fazliu, përfaqësues i QPS; Nëse një familje ka persona me probleme shëndetësore ju takon ndihma, por ka përjashtim rasti kur në bazë të dokumenteve del se dy persona të kësaj familje janë në gjendje të punojnë, atëherë atyre nuk ju takon asistencë sociale. Pjesa nën moshën 5 vjeçare që duhet të ketë një fëmijë e ti takoj ndihma është e padrejtë për mua, por është një ligj në kundërshtim me kohen, duhet me qenë që deri në moshën 16 vjeçare e më poshtë që të jenë përfitues. Mirë që është arrit edhe me i punësuar disa prej tyre, është interes i qendrës. Jemi për me i përfaqësuar e me ju ndihmuar por si asistencë sociale e dimë krejt që edhe i dembelon njerëzit. Numri është shumë i ulët me Komunitat të tjera.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Në emër të Komitetit të falënderoi për pjesëmarrjen.

z.Besnik Seferi; Kisha kërkuar që herave tjera informatën ta kemi në formë të shkruar, sepse gjithmonë mbasin shënimet ndër vite që na ndihmojnë me bë krahasime.

Pika 3

Propozim për organizimin e takimeve me institucionet qendrore për çështjen : Lloji i ndihmës së mundëshme për komunitetet Ashkali dhe Rom të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Lidhur me këtë pikë kam diskutuar edhe me zonjën Elizabet që është zyrtare në kuadër të zyrës së Kryeministrit, ajo më ka premtuar që do të na mbështet. Është takimi i parë, i kemi ftuar edhe drejtorët dhe e kemi prezantuar edhe te Kryetari.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Kuptoj që s'mundeni me i arrit të gjitha, për me pas një plan ju duhet me u aktivizuar më shumë tani, mbase është koha kur duhet me i caktuar disa prioritetet. Te çështja e donatorëve më parë duhet me qenë, Komiteti ai që angazhohet, por ju duhet me qenë më konkret me propozime, një ose dy mundësisht janë me i bërë në vit për me pas mundësi me i futë mandej në buxhet të Komunës.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Te pika e 5 duhet me nxjerr një analizë, gjithë bugjeti ka shkruar në qira të personave.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Nuk është vetëm aty buxheti, duhet me kërkuar edhe në tjerat drejtime, dhe duhet me ardhur me projekte konkrete.

z.Besnik Seferi; Ato qka i kamë pa në teren i kam ngrit, tereni flet diçka tjetër e drejtorët diçka tjetër po deklarojnë, fola në aspekte të përgjithshme.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; E pashë çështjen që folët me raste konkrete.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Kisha propozuar që me pas një takim edhe me Ministrin nëse jo me Ministrin atëherë me Zëvendësministrin për Komunitete. Kemi nisur mbledhjen me konstatimin se nevojat janë të ndryshme, me vizita në teren të bëhet konform vizitave që do ti bëjmë, dhe që i kemi bërë para disa muajve.

z.Besnik Seferi; A mundë të jetë propozim për marrjen e Komunave si shembull.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Po e marrë si propozim prej ktuhit, kam të drejtë se në bazë të atyre i kemi ngrit kapacitete. Duhet të bëjmë një plan të punëve.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Zyrës së Kryetarit, Kryesuesit të Kuvendit, ZKK-së, DSHMS-së si dhe OJQ-ve që të fillojnë përgaditjet për hartimin e Planit të Veprimit Lokal për Komunitete.**

Pika 5

Propozim për krijimin e analizës së çështjes së strehimit dhe banimit të komuniteteve,

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Propozoj që ti dërgohet ZKKK-së.

z.Besnik Seferi; Sa i përket kësaj, një analizë të tillë mund ta bëjmë edhe vet ne si Komitet. Pra duhet të jemi të saktë edhe në të ardhmen çka po kërkojmë. ZKKK-ja duhet të jetë ç'do herë në takime tona që të na njoftojë për statistika. Është mirë që si analizë, ne duhet të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; KPK-ja duhet të japi inputet pasi të kryhet, nga ana e QPS-së te zyra e ZKKK-së nëse bashkëpunojmë kishte me qenë më kredibil, bile me dalë nga DSHMS-së, rekomandimi që për këtë analizë ti kërkojmë QPS-së dhe ZKKK-së, por ne si Komitet nuk mundemi me bërë këtë analizë.

z.Besnik Seferi; Unë nuk thash ta marrim si përgjegjësi, ku e patëm raportimin e drejtorit të QPS-së, tu japim përgjegjësi drejtorive, që të dalin në teren, por të jemi edhe na pjesë e analizës.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Drejtoritë, duhet me ardhur me shifra konkrete te çështja e banimit.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi DSHMS-së dhe ZKKK-së, të fillojnë të hartojnë analizen e çështjes së banimit, duke qenë në kordinim me KPK-në.**

z.Arton Demiri; Pak prej provoje po ju flas, duhet të kemi më shumë bashkëpunim me ZKKK-në

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Çka mundemi me bashkëpunuar më shumë me ZKKK-në, ju lutem tregomëni si të bashkëpunoj më shumë.

z.Arton Demiri; Ata të parët edhe se kanë ditë, por porosia ime është të kemi bashkëpunim më shumë me ZKKK-në.

Pika 6

Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 16:00h

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi